

ekspozita

Prej reales në fantazmagoriken

Ekspozita personale e Angesa Muharremi, "Udhëtimi i dytë", çelët sonte ora 19.00. Profesor Ilir Martini e shikon ekspozitën e Angesës si kërkesë për eksplorim të botës së brendshme, ku arti puqet me idenë, imagjinatën, dhe cdo gjë fillon nga realja, shndërohet në diçka kozmike, estetike, e argumentuar nëpërmjet penelut, ku fantazmagoria është praktikë e angazhimit moral, estetike nëpërmjet ndjenjave, mendimeve, emocioneve njerëzore. Veprat e krijuara nga Angesa Muharremi shprehin atë ndikimin individual, të një vlerësimi objektiv dhe subjektiv, të një reale e cila gjen formën në abstrakten kozmike, forma është e lakuar apo në disa raste e rumbullakët që ngjanë me rrathët e Dante Aligerit, në një kuptim objektiv, por jo edhe tematik. Ngjyrat janë të ngrohta, të ndezura, e kuqja, bënë lojë më të verdhën, sikurse grija me blunë, dhe e thërrasin ngjyrën neutrale, të bardhën, e cila i ndan dhe i bashkon të gjitha në pëlhurë. Përplasja e ngjyrave, dhe krijimi i formave, është i menduar dhe kontrolluar nga dora e artistes. Këtu dukshëm vërehet se arti nuk është vetëm dije për botën, por ka qenë e mbetet, ashtu si filozofia, një armë e fuqishme për formimin e personalitetit të njeriut dhe edukimin e tij, për orientimin e krijimtarisë emocionale dhe praktike. Arti bën thirrje të një realiteti të ri, e ai është kontakti me kozmosin, apo rrotullimi rreth lartësisë së përjetësisë, ku bluja reflekton perspektivën e së ardhmes, gjithnjë nën kompozimin e ngjyrave tjera të ngrohta. Të shtrira në kompozicion, nënë lëvizjen e rregullt të formave dhe ngjyrave, arti i krijuar nga Muharremi bëhet mjet i një horizonti të gjerë spektaklesh, vijash, formash dhe ngjashmërisë në mes filozofisë dhe artit. Struktura, dhe ngjarja që krijon krijuesja, përqipet të futet në anët më të thella të botës dhe kozmosit, duke shpallur thellbin e dukurive, që synon të kuptojë ngjarjet, sfidat të një mekanizmi të brendshme njerëzor dhe artistik. Koka e saj shpërthen, si një magmë, dhe bëhet vullkan që digjet mbi domethënien e vlerave. Modelimi i shpirtit, fantazisë krijon unitetin e anës emocionale dhe asaj intelektuale. Roli pozitiv është shpikja e një ruge, apo zbulimi i hekurudhës së përjetshme të ngjyrës, lëvizjes, rrotullimit ku graviteti nuk ka forcë të tërheqë asgjë, dhe çdo formë qëndron sipër hapësirës apo në mes të kompozicionit. Gjuha artistike, nën ndihmën e elementeve figurative shpalos atë pasionin e pasqyrimit të realitetit të gjerë global dhe mbi global.

Prof. Asc. Ilir Martini



“Kosovën në BE, mund ta çojn

Teatri si ambasador. Regjisorët e teatrit Kosovar si Bekim Lumi dhe Jeton Neziraj i tregojnë, me punën e tyre, publikut të BE, se Kosova i përket Evropës

THOMAS HAHN

“Kthehu shëndoshi”, më thuhet në përgjithësi nga miqtë dhe të njohurit, kur tregoj se planifikoj një udhëtim në Kosovë. Asgjë nuk frikëson më shumë se sa një terra incognita. Shikuar nga Parisi, madje edhe Irani duket më i besueshëm. Nga atje ka ekspozita dhe filma, të cilat shfaqen nëpër festivale. Artistët iranianë, të cilët dikur kishin ikur në ekzil nga Shahu, janë pjesë e përhershme përbërëse e skenës artistike. Kush dëshiron, mund ta krijojë në Evropën Perëndimore një pamje të Teheranit. Dhe Beogradin, eventualisht. Por, si duket në Prishtinë? Aq afër, aq larg, aq misterioze. Por, çdokush e di, e merr me mend apo e ndjen: Në qoftë se do të dështonte projekti i Kosovës, atëherë e tërë Evropa do të kaqandisej në krizë. Kërkimi i temave nën shprehjen “Kosovë” të njëra prej të përditshmeve më të mëdha gjermane rezultojn, për shembull, me asnjë shënim të vetëm ndërmjet gushtit 2011 dhe dhjetorit 2012. Nëse ashtu, atëherë Kosova do të perceptohet si “failed state”, në të cilën humbasin miliardat e BE-së, ndërkohë që korrupsioni do të ngrihet gati në qëllim kryesor të shtetit. Çfarë të bëhet? Sikur ta dinim...! Evropa është e hutuar dhe opinionin po e humb regionin nga vrojtimi. Por vetëm vetëdija publike mund ta krijojë presionin e nevojshëm dhe ta nxisë politikën për hapa vërtet efektive. Mirëpo, përmes cilëve vektorë një vend me më pak se dy milionë banorë mund të bëhet i njohur te ata, të cilët, më për-

para udhëtojnë për në Filipine se sa në Ballkan? Përmes kuzhinës, si Japonia apo Italia? Përmes elektronikës, si Koreja Jugore? Sportistëve? Muzikës? E gjitha kjo bie në fushën e argëtimit dhe konsumimit, por që eksporti në këto sektor të funksionojë, duhet më përpara të ndërtohet një markë. Mirëpo, edhe po qe se Kosova do të mund të hidhte në peshore një produkt të vërtetë që krijon identitet, por ende mungon fuqia e marketingut. Këtu nuk janë fitoret në sport, në rafshin ndërkombëtar. Ato vërtet krijojnë shkëlqim dhe fuqi veprimi, por atletët tregojnë pak për kulturën e vendit të tyre. Jo, fjala është për artin, në llojin e tij më të përpikët të paraqitjes. Këtu vlen kreativiteti i individit, dhe ai në çdo vend të botës dhe në çdo rreth kulturor mund të vendos një raport me botën. Ai transmeton pamjen e rrethit të tij kulturor dhe të gjendjes së zhvillimit të shoqërisë të cilës i takon. Në

Prishtinë gjenden ambasadorët të tillë. Ata janë autorë dhe regjisorë teatri, produktet e të cilëve krijojnë një lidhje me Evropën dhe tematizojnë çështje të ndryshme. Ata i lejojnë shikuesit, i cili nga lajmet zyrtare nuk mëson asgjë për realitetin e jetës në Kosovë, që të ndërtojë një lidhje. Që ata të shfaqen në Evropën Perëndimore, do të duhej të ishte caku i dorës së parë i politikave kulturore. Shumica e vendeve evropërdimore përkrahin turmet jashtë vendit të artistëve të tyre për këtë qëllim. Autorët dhe regjisorët e teatrit si Bekim Lumi dhe Jeton Neziraj i tregojnë, me punën e tyre, publikut në BE, se Kosova i përket Evropës. Interesimi në Evropën Perëndimore për këto vepra dhe për realitetin e Kosovës është i madh. Kjo vlen sidomos për produksionet më të reja të Nezirajt, “Yue Madeleine Yue” dhe “Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës”. Dramat e tija trajtojnë konfliktet brenda shoqërisë kosovare, por ato nuk duhet të vështrohen ndaras dhe jashtë ngjarjeve të republikës së re. Dëbimi i familjes rome nga Gjermania në dramën “Yue Madeleine Yue”, i vendos qëllimshëm në qendër të vëmendjes marrëdhëniet mes shteteve dhe kulturave të ndryshme. Mirë do të ishte të shihet një

dramë për sukseset e EULEX-it në Kosovë. Por, sikur do të kishte suksese, atëherë do të ishte më pak emocionuese që ato të trajtohen në skenë. Teatri jeton nga konfliktet që përjetojnë nga njerëzit që gjenden para detyrave të pazgjidhshme. Dramë apo satirë, tragjedi apo komedi, të dyja mund të çojnë në katars. Teatri vë në pyetje raportin ndaj vdekjes, ndaj jetës ose ndaj pushtetit. Detyra e tij nuk është të vendosë teza, por të vendosë kurthe, në të cilat shikuesi do të ketë rastin që ta vras mendjen për raportin e tij ndaj vetvetes dhe ndaj mjedisit të tij jetësor. Kosova, në përshtatje të mundësive materiale, praktikon një teatër të pastër; me aktorë me talent freskues e me skenografi minimale. Në “Fluturimin mbi Teatrin e Kosovës” rekuizitat e vetme i përbëjnë disa karrige rrotulluese, një grilë dhe një grumbull balonash. Dhe kjo natyrisht i falet edhe shpresës, që me këto shfaqje të udhëtohet. Në festivalin e Lajpcigut euro-scene kjo trupë teatri është gati mysafir i përhershëm dhe aty më 2012 e prezantoi “Yue Madeleine Yue”, një tragjikomedi për një familje të romëve të dëbuar nga Gjermania dhe të keqtrajtuar prapë në Kosovë. Leximi i parë i përkthimit në gjermanisht të “Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës” u mbajt në janar 2013 në Volkstheater të Vjenës. Në këtë dramë, një teknik skene, i avancuar nga qeveria në regjisor, dëshiron ta përshkojë botën me një aeroplan të ndërthurur vetë dhe të llobojë për njohjen e Republikës së Kosovës. Metafora e ëndrrës për liri, sidomos për liri nga vizat, dhe mosmbështetja e kësaj përpjekje, përbajnë një komikë, e cila mund të shkaktojë tensione. Do të ishte e rëndësishme, në qoftë se kjo shfaqje do të mund të fillonte udhëtimin nëpër Evropë. Një shfaqje e mirë është gjithmonë ajo e cila shkakton një debat edhe

“Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës” është një shfaqje patriotike, pikërisht këtu artistët nga Prishtina mund të punojnë në nivel të njëjtë bashkë me ata të Evropës Perëndimore. Ky lloj i produksioneve është tashmë kohë të gjatë i përditshëm në Evropën Perëndimore. Dhe në këtë mënyrë kjo shfaqje ndihmon që Kosova të bëhet një vend në zemër të Evropës